



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

ZYRA E KRYETARIT

01-030-40699/24

05.12.2024

Bazuar ne nenin 81 te Ligjit e Prokurimit Publik nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe amandamentuar me LPP nr, 04/l-237 atë Nr. 05/L-068 dhe Nr.05/L-092 , mbi Aktivitetet e Menaxhimit te projektit dhe kontratës, ZKA , bie ketë :

V E N D I M

Qe për Menaxhimin e kontratës nr. 109-2024 - te datës 18.09.2024 me numër te prokurimit 634-24-7834-5-2-1 Titull: Ankand publik për shitje te inventarit te institucioneve në Komunen e Klinë ,me operatorin ekonomik person fizik Leotrim Berisha me seli në Kline

Për menaxhim te kontratës do te jete z. RONAN BEKTI nga Drejtoria e Arsimit derisa Menaxheri i projektit i njesise kerkuese, si bartës i aktiviteve te programit , dhe implementues i projektit Qemajl Sejdiija

Plani për implementim i kontratës 20 dite
Vlera e kontratës është 684.70 euro

- Menaxheri i projektit ,si edhe përgjegjësi për menaxhimin e kontratës , do te bëje raport të punëve dhe përcjellje për pranim.
- Kryesuesi i aktivitetit te kontrates do te informoj ne gjithsecilën faze te aktiviteve zyrën e prokurimit, dhe pas perfundimit te kontrates sjelle ne Zyre te prokurimit raportin detal mbi aktivitetin e menagjimit te kontratës.
- Vendimi do te i dorzohet menagjerit te projektit së bashku me kontrate, ofertën financiare.
- Vendimit i bashkëngjiten : kontrata, sigurimi i ekzekutimit.

ZKA – KRYETARI
z. ZENUN ELEZAJ





KOMUNA KLINË

Zyra e prokurimit

01/Nr 030-40699/24

DATE 05.12.2024

KONTRATË nr. 109-2024

634-24-11365-2-6-10 me numër identifikues:

Neni 1 Lënda

KJO KONTRATË e lidhur më 04.12.2024 në mes të: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë, dhe **Leotrim Berisha** (këtu e tutje i referuar si "Blerësi"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar tenderët për shitje të aseteve,

Nr	Emertimi i mallit	Sasia	Çmimi fillestar	Totali	Çmimi i ofruar
1	Monitor	15	0.2	3	3
2	Shtepiza	26	0.2	13	13
3	Tavolin Pune /banka (shk.Luigj Gurakuqi-Klinë, SHk.Motrat Qiriaz -Klinë)	250	0.3	75	75
4	Karriga Ulës (shk.Luigj Gurakuqi-Klinë, SHk.Motrat Qiriaz -Klinë)	800	0.3	240	260

5	Telivizor	1	0.2	0.2	0.2
6	UPS	18	0.1	1.8	1.8
7	Telefon fiks	1	0.1	0.1	0.1
8	Printer	19	0.1	1.9	1.9
9	Orman	4	1	4	4
10	Vitrina	1	1	1	1
11	Nxemje	3	0.5	1.5	1.5
12	Fotokopje	4	1	4	4
13	Skaner	2	0.5	1	1
14	Përforcus te rrymës	2	0.5	1	1
15	Termo për Nxemje	2	0.5	1	1
16	Makin shkrimi	1	0.5	0.5	0.5
17	Vitrina Druri	1	1	1	1
18	Kallda per nxemje qendrore(Shk.Luigj Gurakuqi –Klinë dhe Shk.Ymer Berisha –Siqevë)	2	50	100	100
19	Rroba Larse (çerdhja)	1	1	1	1
20	Xhama (shk.Zgjimi-Gremnik)	90	0.1	9	9
21	Enelarse (çerdhja)	1	1	1	1
22	Fotokopje (çerdhja)	1	0.5	0.5	0.5
23	Llamarinë (Shk.Xhafer Gashi – Perqevë)	500	0.3	150	200
24	Dyer Plastike(Palestra “Adem Jashari “-Klinë)	12	0.2	2.4	2.4
25	Shole te WC	8	0.1	0.8	0.8
			Totali:	614.7	684.7

TANI KJO MARRËVESHTJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj Autoritetin Kontraktues për marrjen e Asetit, Çmimin e Kontratës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar me Kontratë.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lëshoj Asetet në pajtim me dispozitat e kontratës.

Neni 2 Lokacioni i Aseteve

2.1 Lokacioni i asetëve është *Ne institucione te Komunës se Klinës*

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së asetëve është *[shëno emrin dhe informatat kontaktuese të zyrtarit.]*

Neni 3 Çmimi i kontratës

3.1 Çmimi total do të jetë: 684.70 €; Gjashtëqind e tetëdhjetë e katër Euro e shtatëdhjetë Cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Blerësi i ka borxh Autoritetit Kontraktues sipas kontratës.

3.3 Çmimi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve;
- (d) Tenderi i Blerësit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe [[angleze][shqipe][serbe]¹] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Labinot Morina
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës për Prokurim
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2024
Vula:	



Për Blerësin

Emri:	LEORIN BERISHA
Pozita:	PERSON FIZIK
Nënshkrimi:	
Data:	04.12.2024
Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA II E KONTRATES: KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Blerësit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Asetet" në lidhje me këtë kontratë përkufizohen në Përshkrimin e Aseteve.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që shet Shërbimet, siç specifikohet në Fletën e të Dhënave të Tenderit

1.4 "Blerësi" do të thotë një person natyral ose ligjorë që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate bënë blerjen e asetëve të cilat janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë" nënkupton palët që nënshkruajnë kontratën.

1.6 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma që do ti paguhet autoriteti kontraktues sipas specifikimit në formën e kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 Ligjet e Kosovës në fuqi do të aplikohen në të gjitha çështjet që nuk mbulohen me dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata relevante në Prishtinë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet me shkrim në mes të palëve do të hartohen në gjuhën e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Neni 3 Gjendja e Aseteve

3.1 Autoriteti Kontraktues do të shet asetet në baza "të gjendjes aktuale, dhe lokacionit aktual" dhe nuk do të ofroj asnjë garanci apo Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve.

3.2 Blerësi do të mbaj përgjegjësinë e plotë për asetet nga data dhe koha e transferim dhe do të ketë përsipër të gjitha kostot dhe rreziqet në lidhje me asetet në vazhdimësi.

Neni 4 Parimet e përgjithshme të pagesës

4.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

4.2 Blerësi do të bëjë pagesën për Autoritetin Kontraktues në shumën e plotë të Kontratës, siç është përkufizuar në formën e kontratës, brenda dy javë nga data e kontratës. Autoriteti kontraktues do të lëshojë një fletëpranim si dëshmi të pagesës.

4.3 Paga do të bëhet në llogarinë bankare të Autoritetit Kontraktues të cekur në Nenin III dhe do të konsiderohet si pagesë në datën kur kreditohet në llogarinë e Autoritetit Kontraktues.

4.4 Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë këtë kontratë nëse Blerësi ka dështuar të paguaj Çmimin e Plotë të Kontratës brenda një jave nga afati i fundit për pagesë.

5. Transferi i Aseteve

5.1 Lokacioni i asetëve është i specifikuar në Formën e Kontratës.

5.2 Blerësi do të ketë përgjegjësi të plotë dhe do të bartë të gjitha rreziqet dhe kostot lidhur me marrjen, çmontimin, largimin dhe transportimin e asetëve nga lokacioni i përcaktuar më lartë dhe do të bartë dhe paguaj të gjitha kostot e asociuara.

5.3 Blerësi do të marrë asetet brenda një jave nga data kur Autoriteti Kontraktues pranon pagesën për asete .

5.4 Blerësi do të kontaktoj zyrtarin e emëruar në Formën e Kontratës, në adresën e autoritetit kontraktues, siç specifikohet në formën e kontratës, për të aranzhuar datën dhe kohën për marrjen e asetëve.

5.5 Blerësi do të nënshkruaj një Certifikatë të Dorëzimit, që certifikon pranimin e asetëve, në kohën e transferit.

Neni 6

Forca madhore

6.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

6.2 Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozionet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

6.3 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

6.4 Nëse Blerësi kërkon shpenzime shtesë për respektimin e udhëzimeve të Autoritetit Kontraktues ose përdorimin e mënyrave alternative nën Nenin 6.3, shuma e tillë duhet të certifikohet nga Autoritetit Kontraktues.

Neni 7

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

7.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

7.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit [*Specifikoni Komisionin departamentin përgjegjës për pajtim*]. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

8.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose një vendim nga [*specifikon gjykatën kompetente*] në pajtim me Ligjin e Kosovës; ose
- b) kur palët pajtohen, një vendim arbitrimin. Arbitrimi i [*specifiko organin e zgjidhjes së mosmarrëveshjes*] në pajtim me [*specifiko rregullat e arbitrimit (rregullat e Odës Ndërkombëtare të Biznesit, Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Ndërkombëtarë të Tregtisë, ose procedurë tjetër të arbitrimit të njohur ndërkombëtarisht)*].


8.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjes p.sh. gjykata apo arbitrim do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës

Aneksi 2**DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, Leotrim Berisha deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht nenin 3 të Informacionit për Tenderuesit dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Leotrim Berisha
Adresa e plotë:	Volljakë, Klinë
I përfaqësuar nga:	
Emri:	Leotrim Berisha
Pozita:	Shofer
Nënshkrimi:	
Data:	05.11.2024
Vula:	